

|   |        |                                      |            |
|---|--------|--------------------------------------|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA<br>QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA<br>ZYRA E KRYEMINISTRIT - URED PREMJIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER<br>SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR |        |                                      |            |
| Njesia Org.<br>Org. Jedinice<br>Org. Unit   | 02.1-a | Nr. Prot.<br>Broj Prot.<br>Prot. No. | 1284       |
| Nr. i faqeve<br>Br. stranica<br>No. pages   | P/L    | Data:<br>Datum:<br>Date:             | 18/04/2014 |
| Prishtinë / a   |        |                                      |            |




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/183  
Datë: 18.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI  
  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:  
- Zëvendëskryeministrave  
- të gjitha ministrive (ministrave)  
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës  
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/183


Datë: 18.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës në cilësinë e aksionarit të Ndërmarrjes publike Korporata Energjetike e Kosovës - KEK, konform shkresës së Bordit të KEK-ut Nr. 870 të datës 17.04.2014 dhe me qëllim të përkrahjes së kategorive sociale të cilat kanë borxhe të pashlyera ndaj KEK-ut deri më 1 shkurt 2013, i rekomandon Bordit të KEK-ut:
  - 1.1. Të analizoj mundësinë që familjet në asistencë sociale dhe ato që kanë qenë në asistencë sociale deri më 1 shkurt 2013 (gjegjesisht deri në momentin kur distribucioni është privatizuar) tu shlyhen borxhet që kanë ndaj Korporatës Energjetike të Kosovës.
  - 1.2. KEK-u në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale të hartoj listën e familjeve të cilët kanë qenë në asistencë sociale deri më 1 shkurt 2013, duke përfshirë edhe shumën e borxhit të pashlyer që kanë secila nga këto familje ndaj KEK-ut.
  - 1.3. Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron që shlyerja e këtij borxhi i cili nuk ka mundur të inkasohet deri më sot për shkak të pamundësisë së këtyre familjeve për ta përmbushur këtë borxh do t'i shërbej edhe vet KEK-ut me qëllim të pastrimit të pasqyrave financiare nga borxhet e vjetra.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

---

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë